



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 26 qershor 2015, në mbledhjen e XVIII-të (tetëmbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç znj.Endritë Murati e cila mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje i pranishëm ishte, z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen me një fjalë hyrëse rreth kësaj mbledhje dhe shtoi, besoj se rendin e propozuar të ditës dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë, andaj pasi të konstatohet prezenca e këshilltarëve ne mund të fillojmë me punë.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 01 qershor 2015

z.Haki Rudari, theksoi, nuk kam asgjë kundër, në kuptimin personal të diskutimit, mirëpo ka të bëjë me mbledhjen e fundit, dhe për këtë dua të ngris një çështje të cilën e kam nxjerrë nga Rregullorja e Punës së Kuvendit ku në nenin 35 thuhet, Grupet e këshilltarëve, këshilltarët dhe trupat përfaqësuese të Kuvendit, përkatësisht Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit, kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës duke paraqitur një arsyetim të shkurtë të propozimit të paraqitur, pastaj në nenin 37 thuhet, për propozimet për ndryshimet apo plotësimet e rendit të ditës nuk hapet

debat por pas arsyetimit të shkurtë të propozuesit, propozimi kalohet në votim, pra dua të ngris si çështje apo vërejtje sepse në mbledhjen e fundit propozimet të cilat i kemi paraqitur në emër të Grupit nuk janë hedhur në votim, andaj meqë prezent këtu është edhe Kryetari i Komunës, kërkoj që në mbledhjet e radhës të respektohet në tërësi Rregullorja e Punës së Kuvendit.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dëshiroj të jap një sqarim parafolësit lidhur me çështjen e ngritur, nuk jam në dijeni se a i keni lexuar nenet e Rregullores në tërësi apo pjesë pjesë sepse për propozime për plotësime dhe ndryshime të rendit të ditës është e vërtetë se nuk ka debat, por është edhe e vërteta tjetër që Kryesuesi i Kuvendit ose zyrtarë nga Ekzekutivi i Komunës kanë të drejtë të japin sqarime, andaj unë i kam dhënë sqarimet e nevojshme dhe prapë i përsërisë se në rastet kur kemi propozime të tilla mirëpo nuk kemi material të nevojshëm për diskutime nuk mund të zhvillojmë debate sepse materialet përkatëse i propozon Ekzekutivi i Komunës dhe vetëm atëherë mund të debatojmë. Pra sqarimet nga ana ime kanë qenë këto që i ceka, por si do që të jetë unë do të marrë këtë që e tha parafolësi dhe në të ardhmen do të hedh në votim propozimet pavarësisht kësaj që e thash.

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Korniza Afatmesme Buxhetore 2016 - 2018

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në Komitetin për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë dokument, mbledhje në të cilën vlen të ceket se debati ka qenë mjaft konstruktiv. Drejtorët e Drejtorive kanë qenë prezentë dhe i kanë evidentuar të gjitha propozimet ose të them kërkesat që kanë rrjedh nga diskutimet e anëtarëve të KPF-së për të cilat është menduar se janë me vend, mirëpo gjatë hartimit të Kornizës Buxhetore për bazë janë marrë edhe diskutimet nga debati publik i Kryetarit të Komunës me qytetarë dhe nga takimi publik i KPF-së me qytetarë nga i cili kanë rrjedh rreth 20 propozime të ndryshme ku disa më të rëndësishmet janë futur në materialin përkatës. Pra ky dokument është fillestar sa i përket përgatitjes së projektbuxhetit të Komunës për vitin 2016 dhe projekteve prioritare për vitet 2016–2018 i cili miratohet deri në fund të muajit shtator, kështu që deri në atë kohë dokumenti mund të plotësohet dhe ndryshohet me ndonjë propozim projekt i cili konsiderohet i nevojshëm.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016–2018, ndër të tjera veçoi, për shkak të planifikimit të sigurimeve shëndetësore dhe kompensimit për përvojën e punës për të gjithë të punësuarit, si rezultat i kësaj është rritur granda i arsimit për arsye se këtu bie pesha më e madhe e planifikimit kurse është zvogëluar granda i administratës, pra kjo ka bërë që të rritet kategoria e pagave dhe të zvogëlohet kategoria e kapitaleve, ku nëse e krahasojmë me vitin aktual shuma arrin afër 1 milion euro, andaj kjo ka ndikuar që shumë kërkesa të qytetarëve të mbeten pa u përfshirë në këtë dokument, mirëpo mbesim me shpresë që në Qarkoren Buxhetore 2016/02 ose sipas nevojës 2016/03 të ketë ndryshime në mënyrë që deri në fund të muajit shtator, ku edhe do të kemi para vetës propozim projektbuxhetin e Komunës për vitin 2016 dhe projektet prioritare për vitet 2016–2018, kjo gjendje të jetë më e favorshme në dobi të investimeve kapitale.

z.Bahri Blakçori, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim dhe e mbështesim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016 – 2018, dhe mendojmë se është bërë një punë jashtëzakonisht shumë e mirë dhe është bërë një shpërndarje në nivelin më të mirë të mundshëm në kushtet dhe rrethanat që ekzistojnë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne si Komitet për Politikë dhe Financa kemi mbajtur një debat me qytetarë më 16.06.2015, dhe në atë takim saktësisht janë paraqitur 21 kërkesa të qytetarëve për projekte të cilësuar si më emergjente në Komunën e Podujevës. Kurse dje kemi mbajtur mbledhjen e KPF-së ku me drejtorët e disa Drejtorive kemi diskutuar lidhur me këtë Kornizë, disa nga kërkesat e dala nga takimi me qytetarë të cilat kryesisht kanë të bëjnë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtorinë e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, janë marrë parasysh nga drejtorët përkatës dhe janë përfshirë në prioritete. Ne si grup nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës kërkojmë që ato kërkesa të merren parasysh sepse janë nga fshatra të ndryshme dhe të cilat mendoj se janë emergjente dhe janë reale, këtë e them duke u mbështetur në faktin se ato lokalitete i kemi vizituar edhe ne si opozitë por besoj se edhe nga drejtorët e Drejtorive. Gjithashtu ne si Grup kemi vërejtje sa i përket të të metave të projekteve të Drejtorive përkatëse ose thënë ndryshe fillimin e projekteve pa procedura, gjë e cila vazhdimisht paraqet problem si në vitet pasuese ashtu edhe dëmton buxhetin e Komunës, po ashtu planifikohen projekte por nuk parashihen mjete të mjaftueshme për realizimin e atyre projekteve ku rezultat i kësaj po dëmtohet buxheti i paraparë për projekte të planifikuara për vitin pasues, e them këtë duke pasur parasysh faktin që në këtë legjislaturë rreth 90% të projekteve të cilat kanë filluar në bazë të mjeteve buxhetore të parapara për atë nuk kanë mundur të përfundojnë brenda vitit kalendarik, kështu që sipas kësaj Kornize, me përjashtim të qytetit që janë paraparë mbi 700,000.00 €, në asnjë lokalitet tjetër nuk janë paraparë mjete të caktuara për ndonjë projekt. Unë e siguroj këtë Kuvend se me rishikimin e buxhetit për vitin 2016 prapë Ekzekutivi i Komunës do të jetë i detyruar të bëjë ndryshimin e projekteve dhe parashikimin e mjeteve buxhetore me qëllim të plotësimit të projekteve konkrete, ose do të jenë të detyruar që të bëjnë pagesa të dhunshme përmes Gjykatës për operatorët që i kanë kryer punët në vende të caktuara. Është shumë lehtë t'iu thuhet qytetarëve se kemi papapaparë mjete buxhetore, shembull 30,000.00€ ose 50,000.00€ për ndonjë rrugë e cila kushton 80,000.00€ ose 100,000.00€, dhe në këtë rast mendoj dhe disponimi dhe propozimi im është se shumë më mirë do të ishte që t'i kemi 10 projekte për një vit dhe ato projekte të përfundojnë me atë buxhet dhe me atë planifikim brenda një viti kalendarik, se sa të shpërndajmë projekte të shumta në lokalitete dhe të mos përfundojnë si shkak i mungesës së mjaftueshme të buxhetit për investime kapitale. Sa i përket Misionit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave mendoj se Komuna e Podujevës emergjencë ka pas në tri fusha deri në këtë fazë ku tani jemi rreth 80% në fazën e kërkesave me kilometra që janë të përfunduara por kemi edhe rrugë që kërkohet buxhet më i vogël e të cilat, me përjashtim të vendeve rurale, Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit kanë mundësi t'i kryejnë ato, shembull, sektorit të shërbimeve publike në misionin e tij e ka edhe menaxhimin e mbeturinave, furnizimin me ujë të pijes, bashkëpunimin me kompaninë e ujësjellësit, zgjerimin e sistemit të ndriçimit sigurimit dhe mirëmbajtjen e parqeve publike dhe hapësirave të caktuara, andaj unë mendoj se sa i përket furnizimit me ujë të pijes ne Komuna e Podujevës kemi mbetur me gjendjen më të keqe nga 7 regjionet përkatëse, e ceka këtë ngase në takimin publik të KPF-së me

qytetarë ka pasur kërkesa për furnizim me ujë të pijes në disa lokalitete ku rrjeti është i shtrirë mirëpo mungon uji dhe për këtë mendoj se Drejtoria përkatëse të bashkëpunoj shumë më ngushtë me kompaninë e ujësjellësit në mënyrë që të siguroj së paku furnizimin me ujë të pijes si element thelbësor për qytetarë, gjithashtu jemi dëshmitarë të deponive të egra të mbeturinave dhe për këtë nuk jam në dijeni për kompanitë e pastrimit se ku e bëjnë deponimin e mbeturinave kur deponia e cila gjendet në fshatin Dumnicë është mbyllur dhe nuk posedon licencë nga Ministria e Planifikimit Hapësinorë, pra kam pyetje konkrete për drejtorin e Drejtorisë përkatëse, ku shprezen mbeturinat e mbledhura nga kompanitë përkatëse dhe si është zgjidhur ky problem deri më tani që nga mbyllja e deponisë si dhe, pse nuk janë krijuar kushtet që të bëhet një deponi e licencuar dhe sipas standardeve ligjore.

Drejtorja e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, në mision, e ka mbikëqyrjen profesionale gjatë ekzekutimit të punimeve, ndërtimit dhe rindërtimit, është radha e tretë që kërkoj shpjegime dhe sqarime rreth demolimit dhe gjendjes së objektit, ish Banka Private e Biznesit, i cili është dhënë në shfrytëzim, çështje për të cilën edhe me Rregulloren përkatëse thuhet se qiramarrësi nuk guxon të ndryshoi ose të punoj pa mbikëqyrjen e organit i cili e ka dhënë lejen, meqë prezent është edhe drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, kjo çështje ndërlidhet edhe me këtë Drejtori e cila ka qenë përgjegjëse të përcjellë ato punime konkretisht heqjen e shtyllës, si dhe kthimin e përgjigjes nga ana e fakultetit teknik për statikat e atij objekti, pra ku ka përfunduar ai proces dhe cilat masa janë marrë ndaj qiramarrësit për punët e kryera pa leje të Komunës apo mosrespektimin e vendimeve të miratuara në këtë Kuvend.

z.Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje e kemi analizuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016–2018, që për ne është një dokument shumë i rëndësishëm dhe duhet të bëhet një analizë e hollësishme për shpenzimet publike dhe të njëjtën kohë të përcaktohen prioritetet kryesore për zhvillimin e Komunës në tërësi. Hartimi i kësaj Kornize përveç që është një detyrim për institucionet buxhetore komunale e cila kërkohet me Qarkoren Buxhetore 2016/01 lëshuar nga Ministria e Financave përbën edhe një obligim para qytetarëve që të kemi kujdes në një menaxhim sa më të mirë të këtyre mjeteve. Përkundër investimeve milionëshe që janë bërë nga paslufta e këndej, gjendja ekonomike e qytetarëve është e rëndë si në aspektin lokal ashtu edhe në atë qendrorë, e kjo u vërtetua edhe me ikjen masive të qytetarëve në shtetet të ndryshme të Evropës e që po ashtu ishte e prekur edhe Komuna jonë. Edhe pas 16 vitesh së çlirimit të Komunës tonë ende kemi mungesë të një tregu të gjelbër në mënyrë që qytetarët do të mund ta shfrytëzonin për shitjen e produkteve ushqimore, respektivisht bulmeti, kemi raste që djathi, qumështi dhe shumë produkte tjera ende shiten nëpër trotuare të rrugëve të Komunës tonë, gjë e cila duhet pasur parasysh se kjo gjendje paraqet rrezik permanent për shëndetin e qytetarëve, kësaj mund t'ia shtojmë edhe prerjen apo si të quaj kasaphanën e shpezëve gjegjësisht pulave mbrapa QKMF-së në Podujevë, gjendje e cila është e pa tolerueshme dhe tepër shqetësuese. Gjithashtu pas vizitave që iu kemi bërë shkollave ne si Grup kemi vërejtur se përkundër investimeve në infrastrukturë prapë kemi ngecje dhe të meta, shembull, në shumë shkolla kemi mungesë të terreneve sportive, kabineteve, bibliotekave, mungesë të gjelbërimit dhe në disa raste edhe mungesë të ujit të pijes, pastaj ka edhe rrezik për nxënësit që rrugëtojnë për në shkollë dhe anasjelltas. Një çështje të cilën e kemi hasur dhe që duam të ngrisim këtu është ambulanca e fshatit Shajkoc në të cilën që një kohë të gjatë ka mungesë të ujit

si pasoj e prishjes së një gypi, por që ende nuk janë marrë masa për rregullimin e atij gypi. Kemi ndotje të lumenjve dhe degradim të ambientit në tërësi. Lëvizja Vetëvendosje në parim e përkrah ndarjen e bursave për studentë, ndarjen e subvencioneve për bujqësi, mirëpo në të njëjtën kohë gjatë vizitave që kemi pasur në terren dhe kontakteve kemi hasur në ankesa të shumta për të cilat konsideroj se duhet të eliminohen ato ankesa, vlen të ceket se Komiteti i Arsimit nuk është pyetur fare në lidhje me ndarjen e bursave, unë kam hasur në një mbledhje të Kuvendit të Komunës së Gjilanit ku për këtë çështje në rend dita ka qenë rekomandimi i Komitetit të Arsimit.

Përkundër këtyre çështjeve që i ceka në emër të Grupit, krahas projekteve që janë në Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe ato që do t'i propozoj, besoj se do të kontribuojnë në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve, pra në vazhdim do t'i paraqes propozimet të cilat besoj se Ekzekutivi i Komunës do t'i ketë parasysh, si vijon:

1-Ndërtimi i një shkollës në fshatin Kaçybeg, fshat i cili ka një numër të madh të banorëve dhe që nxënësit e atij fshati udhëtojnë në fshatin Batllavë për t'i ndjekur mësimet, andaj meqë deri tani është thënë se Komuna e Podujevës nuk po ndihmohet nga Niveli Qendror, tani Qeveria e Kosovës udhëhiqet nga Kryeministri Isa Mustafa besoj se do të sjell investime në Komunën tonë, jam në dijeni se kjo është në kompetencë të Ministrisë Arsimit mirëpo mendoj se edhe Komuna duhet të bëjë hapin e vet.

2-Asfaltimi i rrugës në Lagjen Berisha në fshatin Konushec, duke pas parasysh se kjo lagje lidhet me fshatin Penuhë dhe me rrugën magjistrale besoj se kjo rrugë duhet të përfshihet në prioritete, meqë ekzistojnë projekte të cilat përfshijnë rrugica të fshatrave pse mos të përfshihet edhe kjo rrugë e cila lidhë tërë fshatin.

3-Asfaltimi i rrugës në Lagjen Rrahmani në fshatin Dumnice, në konsultim me banorët e atij lokaliteti unë jam informuar se ata banorë kanë paguar edhe kanë hartuar projektin përkatës, andaj mendoj se do të ishte plotësisht e arsyeshme që ajo Lagje të asfaltohej, e them këtë ngase në mbledhjen e KPF-së u ceken disa asfaltime të rrugëve të cilat nuk kanë projekte dhe pa qenë në dijeni se cilat Lagje janë ato, andaj meqë për propozimin që bëra besoj se nuk paraqet kurrfarë problemi nëse përfshihet në kornizë.

4-Rregullimi i oborrit të shkollës së mesme të ulët "Hasan Ramadani" në fshatin Shajkoc, jo pse vijë nga ai lokalitet mirëpo besoj se edhe dy këshilltarë tjerë nga dy partitë tjera këtu janë në dijeni se gjendja e oborrit të shkollës nuk është e mirë, andaj konsideroj se është mirë që Ekzekutivi i Komunës ta ketë parasysh këtë çështje.

5-Rregullimi i terrenit sportiv në shkollën e mesme të ulët "Pavarësia" në fshatin Siboc, kjo shkollë ka nevojë për rregullimin e një terreni sportiv, sepse arsimtarët e edukatës fizike e kanë të pamundur ta mbajnë orën me nxënësit e tyre, dhe kjo mund të ndërlihet me probleme të shumta si pasoj e mos mbajtjes së orës përkatëse.

6-Rregullimi i një parkingu për nxënësit e fshatrave Gllamnik dhe Luzhan, këto kërkesa ishin bërë edhe në takimin publik të KPF-së me qytetarë, mirëpo të gjithë ne që i vizitojmë ato vende apo udhëtojmë në drejtim të Prishtinës vërejmë se nxënësit e atyre dy fshatrave vërtetë janë të rrezikuar, jam në dijeni se ky propozim kërkon kosto financiare mirëpo besoj se në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse kjo çështje do të rregullohej.

7-Asfaltimi i rrugës në Podujevë, Lagja e Dëshmorëve, kjo është kërkesë e banorëve të cilët mendoj se iu janë drejtuar edhe Ekzekutivit të Komunës sepse vërtetë ka një frekuentim të madh të banorëve të atij lokaliteti.

Në vazhdim po e shfrytëzoi rastin t'i paraqesë edhe disa çështje të cilat janë ngritur në mbledhjen e KPF-së, por që dëshiroj të ngritën edhe në këtë mbledhje; te Drejtorja e

Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, që nga numri 7 deri te numri 17 thuhet vetëm, asfaltimi i disa rrugëve, pra është mirë të specifikohen se për cilat rrugë dhe cilat lagje bëhet fjalë, pra mundësisht sot dëshiroj të njoftohemi ne si këshilltarë të Kuvendit më në detaje për çdo fshat dhe lagje, dhe po ashtu edhe për çdo rrugë në qytet rreth kësaj çështje sepse qytetarët janë të interesuar për këtë. Pastaj te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, po ashtu përmenden vetëm, rregullimi i trotuareve afër shkollave, e që edhe këtu është mirë të specifikohet se për cilat shkolla bëhet fjalë për arsye se ne si këshilltarë nuk jemi në dijeni dhe nuk mund të iu japim përgjigje qytetarëve se për cilat hapësira bëhet fjalë.

z.Naim Çunaku, theksoi, konsideroj se që në fillim është dashur të marrë fjalën dhe të njoftoj Kuvendin lidhur me ecurinë e takimit publik të Komitetit për Politikë dhe Financa me qytetarë, dhe kërkesat që në një formë i paraqiti ose që i përmendi Kryesuesi i Kuvendit, kërkesa të cilat i kemi marrë nga përfaqësuesit e fshatrave gjegjësisht nga grupet e interesuara të meseve të caktuara, ne i kemi të evidentuara të gjitha kërkesat mirëpo unë dua që t'i paraqesë para juve vetëm në mënyrë gjenerale kërkesat e paraqitura nga banorët e meseve dhe lokaliteteve të ndryshme të cilëve ne iu premtuam se brenda mundësive buxhetore dhe arsyeshmërisë që e shohin këshilltarët e Kuvendit dhe Ekzekutivi i Komunës, do t'i trajtojmë gjegjësisht do të inkorporohen në projektin final të Kornizës Afatmesme Buxhetore përkatësisht si projekte prioritare për vitin 2016. Edhe kësaj radhe pjesa më e madhe e kërkesave që rrjedhën kryesisht kishin të bënin me investime në infrastrukturë gjegjësisht në asfaltimin e rrugëve, rregullim të fushave të sportit në mese të caktuara, pastaj shqetësuese për qytetarët ishte mjedisi, gjegjësisht trajtimi i ujërave të zeza, mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve, në disa mese pati edhe kërkesë për shtresë të dytë të asfaltit ku sipas tyre del se të gjitha tjerat janë kryer sikurse që pati kërkesë për ndriçimin e rrugëve në fshatin Shajkoc, çështje tjetër për të cilën u bë apel i drejtpërdrejt nga përfaqësuesi i fshatit Metehi për këshilltarët e Kuvendit, kishte të bënte me riaktualizimin e çështjes që ka të bëjë me furnizimin me ujë për 7 fshatra nga Vrella e Revuçit. Duke pas parasysh projektet që janë të hartuara dhe projektuara në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016–2018 dhe kur kemi parasysh kërkesat e qytetarëve në një formë del se jemi aty afër përafrimeve, sepse kërkesat janë për investime kapitale dhe investime në infrastrukturë, edhe kësaj radhe besoj se ka mbet pak sa anash që ta kemi një projekt për zhvillim gjegjësisht për subvencione në ekonomi të cilat do të përmirësonin jetën e qytetarëve dhe gjendjen ekonomike të tyre. Pra unë u mundova në pika të shkurtra të prezantoj takimin e KPF-së me qytetarë i cili ka dal si obligim nga Ministria e Financave, për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016–2018.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, dokumenti që na është dërguar për shqyrtim dhe që sot e kemi para vetës për miratim përkatësisht Korniza Afatmesme Buxhetore 2016–2018, kur lexohet në fillim, veçanërisht; vizioni, deklaratat e misionit dhe strategjia për arritjen e zhvillimeve të dëshiruara, të bënë të besosh se kemi të bëjmë me një dokument aq shumë të nevojshëm për Komunën e Podujevës, mirëpo siç e thotë një proverb Labe (nga e bëra në të thënë është një det i tërë), ngase deklarimi i këtij vizioni dhe përmbajtja e kësaj Kornize buxhetore goxha shumë bien në kundërshtim, dhe unë nuk e besoj se mund të na sqaroi Ekzekutivi i Komunës se në cilën pjesë të këtij dokumenti e gjen atë që është deklaruar si vizion. Që në rendin e parë të tekstit të vizionit, citoj, *Podujeva Komunë moderne, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik*, kurse në brendinë e këtij dokumenti nuk gjendet askund por përkundrazi në këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore Podujeva do të

jetë një Komunë e ngecjes dhe stagnimit ekonomik, madje edhe subvencionet planifikohen të zvogëlohen për 50,000.00 € për vitet në vazhdim, pastaj buxheti për planifikimin dhe zhvillimin ekonomik është aq i mirë sa që e përforcon deklaratën tonë të disahershme, që Komuna jonë gjegjësisht Ekzekutivi i Komunës nuk ka objektiva zhvillimore, nuk ka objektiva për Komunën por ka vetëm për vetveten. Në vend të projekteve zhvillimore, për çdo vit na paraqiten dokumente në të cilat thuhet se bëhet planifikimi për realizimin e mbjelljeve dhe fshirjeve, por unë nuk jam në dijeni se Komuna jonë ka në pronësi të vetë aq shumë sipërfaqe tokë që të merret me këtë gjë, apo ndoshta ndokujt i bie ndër mend se këto prona duhet të kolektivizohen, pastaj nuk ka asnjë planifikim për ndarje në zona funksionale edhe pse në vizion thuhet, citoj, *Komunë atraktive për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, ambient të përshtatshëm për biznes, ndërmarrësi bazuar në iniciativën private, bujqësi, dhe turizëm të zhvilluar*. Është dhënë një shënim që kemi të regjistruar 3598 biznese, mirëpo nuk ka shënime dhe besoj se nuk jeni në dijeni sa prej tyre janë aktive dhe sa të punësuar kanë këto biznese në Komunën tonë. Për Partneritetin Publiko Privat as që i bie ndërmend Ekzekutivit, për bujqësi tani më vetëm dihet qartë me planifikimin se do të ketë zvogëlim të subvencioneve, ndërsa për turizëm të zhvilluar, kjo mbetet vetëm një tog fjalësh për të cilat kemi dëgjuar, përndryshe askund asnjë fjalë në cilat zona të Komunës tonë planifikohet dhe janë atraktive për turizëm të zhvilluar dhe se çka do të investohet dhe çka do të bëhet në ato zona. Viti 2014 pati rritje ekonomike në nivel vendi prej 0.9%, e që i bie se vende të reja pune janë hapur rreth 300, kurse korpusit të papunëve u janë shtuar rreth 30,000, në këtë vit planifikimi është 3.7 %, e nëse e zbërthejmë në shifra i bie që do të ketë rreth 10,000 vende të reja të punës kurse korpusit të papunëve do t'iu shtohen rreth 23.000, dhe kështu vazhdon planifikimi edhe në vitet në vazhdim, andaj krejt kjo e bënë të qartë se cila do të jetë e ardhmja e këtij vendi e në kuadër të saj edhe e Komunës së Podujevës. Në këtë foltore e kam thënë disa herë se Komuna me buxhetin e saj nuk mund të realizoj zhvillim të mjaftueshëm ekonomik, mirëpo gjithsesi mund të orientoj këtë zhvillim, por jo me këtë buxhet të ndarë në këtë formë, por të punohej së paku me buxhetin e realizuar nga të hyrat vetanake do të mund të nxiste projektet për ekonominë e vogla familjare të cilat do të gjeneronin vende pune dhe kapital financiar si dhe do të siguronin bazë që më pas të zhvillohej industria e lartë kultivuese. Me pak buxhet, kultivimi i mjedrës dhe dredhëzës ka pas dhe është duke pas sukses, mirëpo kultivimi edhe i boronicës, aronisë, brusnicës, ribizles, arrës, lajthisë, bimëve mjekuese si dhe mbështetje e interesimeve të tjera që kanë rrethana për sukses, nxitja, motivimi dhe mbështetja për ndryshimin e strukturës pyjore me lloje të reja të drunjëve që do të kenë përdorim edhe industrial, dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme për këtë, do të japin shpresë për më shumë zhvillim, infrastrukturë e deritashme dhe mjete të planifikuara, por që parakusht për zhvillim por jo edhe domosdoshmërisht edhe zhvillim. Dhe krejt kësaj vetëm duhet shtuar edhe një planifikim tjetër të arsimimit nga i tashmi, arsimim vetëm me një ndërrim dhe i cili siguron kuadër ku fëmijët do të mund të mësonin në shkollat tona më shumë për zanate të nevojshme për treg dhe zhvillim, e jo siç është aktualisht ku mjafton të kesh ndokënd në Ekzekutiv apo të jesh pjesë e subjektit politik në pushtet dhe të marrësh një vend pune në shkollat tona dhe të ndjehesh komod, ndërsa mësimdhënia të bëhet më shumë me kurse nëpër shtëpitë e shumë mësimdhënësve, madje n'disa raste duke i kushtëzuar nxënësit.

z.Flakron Gashi, theksoi, për të vërtetuar gjithë atë që e tha kolegu parafolës z.Lutfi Rexhepi, unë dua t'jua rikujtoj i nderuar Kryesues i Kuvendit se ky Kuvend është duke ditur t'iu shmanget Vendimeve që i miraton vetë, ose nuk ka vullnet ose nuk ka fuqi që qeverisjes lokale t'ia imponoj agjendën e paraparë. Ne në muajin dhjetor të vitit të kaluar kemi miratuar Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2015 ku si pjesë përbërëse e atij vendimi është edhe forma tabelare, dhe kjo ndërlidhet pikërisht tek të gjeturat që i ceku parafolësi ku në muajin maj 2015 Komuna do të duhej të sillte në Kuvend Planin Zhvillimor të Komunës dhe kjo gjë nuk ka ndodh, gjithashtu për këtë seancë të muajit qershor ku këshilltarët e Kuvendit do të duhej të kishin para vetës një raport të Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të viti për gjendjen ekonomiko financiare të Komunës, andaj kjo ekskluzivisht vetëm sa e përforcon mendimin e z.Lutfi Rexhepit.

Me qenë se parafolësi shumë gjëra i përmendi nga ato që pata ndër mend t'i them dhe unë, mirëpo do të ndalem te Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, dhe tek Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, së pari është për keqardhje që një Drejtor ose një resor kaq i rëndësishëm të ketë një buxhet të planifikuar prej 140,000.00 € dhe nuk e di se si do të mund të zhvillonte dhe të ketë një zhvillim ekonomik, blerja e softueri dhe participimi me donatorë, gjë për të cilën ne besojmë se do të ndikon por nuk është e kënaqshme dhe e mjaftueshme, gjithashtu edhe për DKRS-në paraqitet apo më mirë të them vetëm bartet nga vitet e kaluara projekti për ndërtimin e Qendrës së Kulturës për të cilin shpresoj të realizohet mirëpo për një numër të popullsisë, 89000 banorë, dhe prej një 30% të moshës rinore që ka kjo Komunë, nuk e di se a do të mjaftojnë dhe cilat do të jenë mjetet që do të realizon projekte kur jemi në dijeni se në disa portale është raportuar për dukuri devijante të nxënësve të shkollave të mesme, gjë e cila neve si subjekt politik PDK na shqetësojnë, pavarësisht se kush qeverisë me Komunën. Të ndalemi dhe të ndërlidhemi, meqë prezent këtu është edhe Kryetari i Komunës i cili e din shumë mirë që për zhvillimin ekonomik gjatë fushatës zgjedhore ka premtuar krijimin e zonës industriale, ka premtuar palestër rekreative sportive në fshatin Kërpimëh, dhe gjithashtu ka bërë premtimin për mundësin e realizimit të projektit të ujësjellësit, që e përmendi edhe z.Naim Çunaku dhe që ka qenë kërkesë edhe e një qytetari, pra ujësjellësin nga Vrella e Revuçit për fshatrat Revuç, Kërpimëh, Metehi, Zakut dhe Dobërdol.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, sa i përket zgjerimit dhe renovimit të shkollave në vitin 2016 në shumën e cekur 130,000.00 €, nuk është cekur ku dhe në cilat shkolla. Ne Grupi nga radhët e LVV-së kërkojmë të ndërtohet një çerdhe publike, pasi që çerdhja e cila është në funksion nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe si shqetësim tjetër për këtë çerdhe kemi edhe sa i përket pushimit verorë që çerdhja aktuale e aplikon në muajt korrik dhe gusht, pse të mos zgjidhet kjo çështje pasi që dashtë e pa dashtë imponohet të merret pushimi gjatë këtyre dy muajve. Çështje tjetër që dua të ngrisë është asfaltimi i rrugëve në qytet planifikim për vitin 2016, kërkojmë që në kuadër të këtij projekti të përfshihet edhe rruga afër Xhamisë së vjetër të qytetit pikërisht në Lagjet Stublla-Babatinca-Gubetini, ku banorët e atyre Lagjeve kanë marrë premtim nga Kryetari i Komunës gjatë fushatës zgjedhore se ajo rrugë do të asfaltohet, do të ndërtohet një fushë sportive, do të menaxhohen mbeturinat në atë pjesë, do të bëhet rregullimi i lumit Llap në atë pjesë dhe do të bëhet ndriçimi i asaj rruge. Shqetësim tjetër është edhe shkolla fillore "Xheladin Rekalu" për shkak se ka mungesë të trotuareve gjë e cila rrezikon nxënësit e asaj shkolle, andaj mendoj këto gjëra duhet të merren parasysh.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, sikurse vitin e kaluar edhe në këtë vit vërehen lëvizje dhe parregullsi në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016-2018. Më duhet të theksoi dhe të kërkoj shpjegime, pse dhe mbi çfarë baze ligjore janë hequr projektet e caktuara nga lista e projekteve me prioritet, kur e them këtë mendoj fillimisht për projektin e vazhimit të asfaltimit të rrugëve në fshatin Revuç për të cilin në vitin e kaluar me rishikim të buxhetit është vendosur në projektet e vitit 2016 me shumë 80,000.00 €, ndërsa tani pa asnjë arsye shihet se është bartur te projektet e vitit 2018 dhe atë me një shumë prej 60,000.00€. duke pasur parasysh gjendjen në të cilën gjendet Komuna jonë e posaçërisht situatën ku projektet fillohen e nuk përfundohen ose kur projektet fillohen pa procedura siç është e cekur në Raportin e Auditorit. Duhet të theksoi se nuk mund të pajtohem me këtë kornizë sepse në mënyrë direkte i diskriminon një pjesë të qytetarëve derisa e favorizon një pjesë tjetër të tyre. Një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kam parashtruar pyetje; pse është tërhequr projekti i fshatit Revuç, dhe kam marrë këtë përgjigje; e dimë që në Revuç janë rrugët e dëmtuara por kur e krahasojmë me fshatrat rurale buzë kufirit i bie që Revuçi është shumë mirë. Unë mendoj se kjo përgjigje është e pabazuar sepse ato krahasime nuk mund të bëhen për shkak se po të shikohej ashtu atëherë pse duhet të ndahen 755,894.00 € për rrugë në qytet e shumë e shumë projekte tjera, e nëse bëhen këto krahasime del se Podujeva me zonat rurale është si New York. Pse nuk bëhen këto krahasime kur planifikohen asfaltime në disa fshatra që kërkohet të asfaltohet edhe shtresa e dytë përderisa ne kemi rrugë të pashtuara fare. Kjo thjesht është e papranueshme dhe madje duke marrë parasysh që rruga e shtruar në vitin e kaluar është dëmtuar edhe njëherë, tregon seriozitetin dhe cilësinë e punimeve që financohen nga Komuna.

Kam edhe pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në Kornizën 2015–2017 ishin të planifikuara 460,000.00 € për projekte në shëndetësi, mes tyre ishte objekti i maternitetit i cili sipas asaj kornize thuhej se është në fazën e pestë, por ne nuk jemi në dijeni se ku gjendemi lidhur me këtë projekt dhe si dhe kur do ta kemi funksional. Gjithashtu në atë Kornizë ishte paraparë edhe objekti i hemodializës i cili në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016–2018 mungon, dhe buxheti për shëndetësi tani është vetëm 200,000.00 €, pse është hequr objekti i hemodializës kur jemi në dijeni për rëndësinë dhe nevojën për atë. Sot derisa ne flasim këtu, i kemi rreth 30 pacientë të cilët transportohen në baza ditore në Prishtinë për të marrë këto shërbime të domosdoshme për jetën e tyre. Nëse nuk kemi të holla për hemodializë atëherë a bënë të dihet se sa i kushton Komunës transporti i pacientëve tanë në Prishtinë në baza ditore. Menaxhimi financiar ka të bëjë me shfrytëzimin efektiv transparent dhe ekonomik të parasë publike, atëherë sa ne jemi duke përmbushur këtë kriter.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, vlen të përsëritet angazhimi dhe përkushtimi i Ekzekutivit të Komunës në veçanti Kryetarit të Komunës z.Agim Veliu, për punën e madhe që është duke u bërë në Komunën e Podujevës për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës. Korniza Afatmesme Buxhetore 2016–2018, nëse analizohet mirë në mënyrë të detajuar sigurisht se do të vërehet projekte të ndryshme të cilat prekin fusha të ndryshme për investime në Komunën e Podujevës, ndërsa sa përket asaj që u cek lidhur me premtimet e Kryetarit të Komunës, duhet pasur parasysh se mandati i Kryetarit ende nuk ka përfunduar, por ka mandat edhe dy vite e gjysmë.

z.Hasan Softolli, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore 2016–2018 paraqet vizionin e Komunës së Podujevës për tri vitet e ardhshme, dhe ky dokument i mundëson Ekzekutiv të Komunës që në mënyrë të qartë t'i realizoj objektivat e caktuara, po ashtu në këtë dokument shihet përkushtimi maksimal i Ekzekutivit të Komunës për të bërë më të mirën e mundshme, si dhe në këtë draft paraqiten synimet e Komunës si, vizioni, misioni, deri te mekanizmat e nevojshëm për ekzekutim të këtyre komponentëve. Në mënyrë të detajuar janë cekur për secilën Drejtori punët dhe objektivat, po ashtu vëmendje të posaçme në këtë dokument i kushtohet performancës e cila është mjet vetërregullues apo kontrollues. Gjithashtu kjo kornizë është në harmoni me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2016/01 lëshuar nga Niveli Qendrorë, e cila paraqet monitorim dhe menaxhim të plotë të programeve komunale të cilat janë hartuar në bazë të strategjisë me qëllim të arritjes së objektivave komunale për tri vitet e ardhshme, po ashtu në këtë kornizë janë bërë analiza dhe vlerësime të të gjitha niveleve hierarkike duke filluar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoritë e Komunës dhe njësit tjera shpenzuese. Projektionet janë bërë duke u mbështetur në burimin e të hyrave dhe mënyra e shpërndarjes së këtyre të hyrave është bërë në mënyrën më të mirë për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe përparim në të gjitha sektorët duke u mbështetur në potencialet financiare dhe njerëzore që ka në dispozicion Komuna jonë, dhe ky dokument jep informacione të hollësishme mbi ecurinë e të hyrave sipas viteve dhe shpenzimeve si dhe analizimet ekonomike në nivel vendi apo makroekonomik dhe në nivel komunal apo mikroekonomik. Sipas KAB, projektioni i të hyrave për vitin 2016 është, 18,446,798.00 € ku 16, 736,000.00 € janë nga grandi qeveritar dhe 1,710,000.00 € janë të hyra vetanake, ndërsa shpërndarja e shpenzimeve është, në paga dhe mëditje 12,061,000.00 €, në mallra dhe shërbime 1,387,000.00 €, në subvencione 740,000.00 €, si dhe në investime kapitale 4,257,000.00 €. Sa i përket investimeve kapitale, në Drejtorinë e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit janë planifikuar 2,177,909.00 €, si për hartimin e planeve rregullative, hartim të projekteve, eksproprijim të tokave, mirëmbajtje të ambientit dhe parqeve, rregullim, riparim dhe pastrim të lumit Llap, asfaltim të rrugëve në qytet dhe në fshatra, pastaj në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit janë paraparë investime në vlerë 1,300,000.00 €, për ndërtim të urave, ndërtim të kanalizimeve, kolektorëve, trotuareve, shenjzime, zgjerim dhe pastrim të shtretërve të lumenjve, ndriçime publike, rregullime në infrastrukturë duke përfshirë edhe infrastrukturën e varrezave, e të tjera, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik janë paraparë investime 140,000.00 €, në Drejtorinë e Administratës janë paraparë 120,000.00 €, në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural janë paraparë për investime 400,000.00 € ku parashihet të bëhet klasifikimi dhe boniteti i tokës, pastaj projekte për bletari, perimekulturë, pemëtari, sistem të ujitjes dhe përkrahje për entitete jo publike. Nga të gjitha këto që u cekën, tregon se Ekzekutivi i Komunës ka transparencë maksimale kur dihet se kjo kornizë ka qenë e hapur edhe në debat publik, po ashtu kur kemi parasysh se investimet bëhen në të gjithë sektorët dhe pa dallim.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, duke marrë për bazë buxhetin dhe nevojat që paraqiten vazhdimisht nga qytetarët, besoj se kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore 2016 - 2018 është planifikuar jashtëzakonisht mirë, për arsye se ka kërkesa për projekte të shumta dhe duke ja shtuar edhe faktin që ka afër 7 vite që nga niveli qendrorë nuk është përkrahur asnjë projekt, atëherë rezulton se të gjitha projekte e deritanishme janë kryer falë menaxhimit të kujdesshëm të financave në Komunën e Podujevës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dua të ndërlidhem me lëvdatat që i bënë këshilltarët e subjektit LDK, dhe më vie mirë që po marrin fjalën dhe po diskutojnë kur Kryetari i Komunës është prezent në mbledhje të Kuvendit, mirëpo unë personalisht ju siguroi një gjë, ata që e lëvdan këtë dokument do të votojnë prapë për ndryshimin e këtyre projekteve me propozim të Ekzekutivit, e them këtë dhe juve po ashtu ju siguroj se po të realizohen këto projekte unë publikisht do të votoja për, por të jenë të bindur dy parafolësit dhe ta mbajnë në mend se ky subjekt do të propozoj dhe ky subjekt me shumicë do të votoj për t'i ndryshuar të gjitha këto projekte. Ndërsa mendoj se deklarata e misionit dhe ajo e vizionit janë në kornizë të cilat i lexoi edhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, andaj nuk ka nevojë të kërkojnë fjalën këshilltarët e Kuvendit dhe t'i lexon ato sepse besoj se jemi në dijeni se çfarë janë ato deklarata, por detyrë e jona është të propozojmë ndonjë projekt konkret, të votojmë ose të kundërshtojmë.

z.Mirsad Kamerolli, nënvizoi, nuk pajtohem aspak me atë që e tha parafolësi z.Rafet Llapashtica. Po të mos ishte dokumenti i Kornizës Afatmesme Buxhetore ashtu siç e thash më parë, unë asnjë fjalë nuk do të kisha thënë.

z.Fidan Rekalu, theksoi, Kryetari i Komunës nuk e ka mandatin që dy vite por është Kryetar i Komunës për katër mandate, dhe të gjitha projektet e zhvilluara dhe të përfunduara deri tani në Komunën e Podujevë, së pari janë planifikuar, janë votuar në Kuvend dhe pastaj janë realizuar.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, ju falënderoj të gjithëve për sugjerimet rreth projektbuxhetit të Komunës për vitin 2016 dhe prioritetet për vitet 2016-2018 edhe pse ato sugjerime ishin në numër shumë të vogël, fatkeqësisht edhe në mbledhjen e KPF-së ka pasur shumë pak propozime konkrete dhe është dashur më shumë të merrem me sqarime, andaj kjo në një formë do të thotë se në përgatitjen e draftit të parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016-2018 për të cilin kemi mbajtur dy debate publike, i kemi afruar apo qëlluar afër 100% projektet prioritare sipas nevojave të paraqitura, pra do të thotë se është një gjë e mirë sepse sot nuk vërejta asnjë projekt shumë serioz të cilin kemi mundur që shkak i harresës të mos e përfshijmë në këtë kornizë, sikurse që nuk vërejta asnjë projekt që është i propozuar pa vend, gjithashtu do të thotë se propozimet tona janë edhe mendime tuajat.

Ju siguroj se në bazë të përvijës dhe njohurive që kam, jam munduar dhe kam bërë përpjekje maksimale që këto propozime, brenda këtij buxheti, duke shkurtuar buxhetin në raport me vitin e kaluar për afër 200,000.00 €, në mënyrë që të përfshihet, 1- vazhdimësi e projekteve, 2-projektet e ndryshme të cilat duhet të përmbillen këtë vit, dhe 3- të ketë përfshirje sa më të gjerë të lokaliteteve ku janë përfshirë së paku 25 lokalitete, mirëpo do të ketë edhe projekte të përgjithshme ku do të përfshihen rreth 40 vende që do të punohet vetëm nga DSHPMSh, por do të ketë edhe projekte që do të harmonizohen me projekte të Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit në mënyrë që të mos punohet me nga dy-tri projekte në një lokalitet.

Çështje tjetër, unë kam përcjellë debatet, dhe nuk do të thotë se të gjitha kërkesat dhe propozimet e dala mund të jenë të arsyeshme, e them këtë ngase kërkesat, shembull, dy kamion me zhavor për shtrimin e një rruge, nuk mund të përfshihen si projekte konkrete, pra këto mund të jenë brenga të qytetarëve dhe probleme të përditshme që neve na paraqiten por nuk mund të parashihen si projekte kapitale. Vlen të ceket se ka pasur kërkesë për projekte të cilat janë paraparë për këtë vit dhe që janë në fazën e tenderimit ose në fazën finale të fillimit të punimeve.

Janë përfshirë tri projekte të cilat i kemi konsideruar si të arsyeshme nga kërkesat që janë bërë në debatin publik me qytetarë të KPF-së, ndërtimi i kanalizimit në disa lagje të fshatit Herticë, mirëpo sot nuk dëgjova ndonjë propozim projekt apo ndonjë propozim për të hequr nga lista e projekteve, por prapë deri në miratimin final në fund të muajit shtator dokumenti mbetet i hapur për ndonjë propozim për ndryshim apo plotësim të projekteve të planifikuara, brenda kësaj Kornize. Na vazhdim do t'i jap disa përgjigje;

Sa i përket problemit me ujë të pijes, unë kam dëshirë të diskutojmë në ndonjë mbledhje dhe jam i hapur për këtë sepse ka çka të bisedohet, përkatësisht për raportet e Komunës së Podujevës me Kompaninë regjionale, cilësinë e ujit dhe kapacitetet tjera. Kurse sa i përket pyetjes se ku shprazen mbeturinat, përgjigja është se të gjitha mbeturinat derdhen në deponinë e mbeturinave në fshatin Dumnice e cila është një ndër 5 deponit e licencuara në Kosovë të cilat i menaxhon Kompania për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë si Shoqëri Aksionare e nivelit qendrorë sepse këto deponi nuk mund të menaxhohen nga Komuna dhe nuk mund të jep licencë Komuna sikurse që nuk mund të krijoj kompani lokale për menaxhimin e mbeturinave. Sa i përket pyetjes në lidhje me tregun e gjelbër, unë japë këtë sqarim, ka më shumë se dy javë që të gjithë tregtarët e bulmetit, pa pagesë të shfrytëzimit të hapësirës, janë duke shitur produktet e tyre në tregun e gjelbër, kurse lidhur me ndërtimin e trotuareve, unë edhe në debatin publikë po edhe në mbledhjen e KPF-së e kam dhënë sqarimin se, ne kemi ndërtuar trotuare edhe në rrugë rajonale dhe regjionale të cilat nuk janë në kompetencë të Komunës, por qëllimi është largimi i rrezikut të nxënësve, pavarësisht kësaj ne edhe këtë vit jemi duke vazhduar me ndërtim të trotuareve, jemi në fazën e fillimit të punimeve në disa fshatra ku janë rreth dhjetëmijë metra katror që do të ndërtohen në këtë vit me kubëza, ndërsa vitin e ardhshëm do të vazhdojmë në rrugë të ndryshme pikërisht aty ku kanë mbetur në fshatra të ndryshme dhe në pjesë të qytetit, kurse në rrugët regjionale i kemi hequr të gjitha projektet për ndërtim të trotuareve për shkak se planifikohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës zgjerimi i rrugës Podujevë – Prishtinë, dhe nuk do të ishte mirë të bëjmë investime të kota. Lidhur me strukturën e projekteve, është kjo që është dhe ndoshta jo të gjitha shkojnë për zhvillimin ekonomik por sigurisht se ndikojnë në zhvillimin ekonomik, pajtohemi edhe ne se ndoshta duhet të ndërrojmë strukturën e investimeve edhe pse brenda Drejtorisë ka ndryshuar bukur shumë, mirëpo tani për tani nuk mund të bëjmë atë sepse kemi nevoja ende të vazhdojmë me investime të tilla, por sigurisht me investimet që do të kryhen në këtë vit sigurisht se vitin pasues përqindja e strukturës së projekteve do të ndryshoj shumë më shumë. Prandaj unë edhe një herë po e përsërisë, jam i hapur për ndonjë propozim projekt konkret.

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, jemi munduar që në bazë të gjendjes faktike në terren dhe kërkesave të qytetarëve të bëjmë hartimin e planifikimeve të projekteve në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016-2018, po ashtu jemi munduar të përfshijmë projekte dhe investime në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, mund të ndodh që ndonjë mes të mos jetë përfshirë në këtë kornizë dhe që ndokush të mos jetë i kënaqur, mirëpo ne jemi të hapur dhe kohë ka ende të jepen propozime, plotësime dhe ndryshime të projekteve konkrete, ndërsa sa i përket pyetjeve të parashtruara nga këshilltarët sot, unë do të jap përgjigje, si vijon;

Propozimi për asfaltimin e rrugës në Lagjen Berisha në fshatin Konushec, kjo Lagje është planifikuar të asfaltohet në vitin 2018, pra dua të them se nuk qëndron ajo që u tha se nuk është përfshirë fare në planifikime. Sa i përket kërkesës për rrugën në Lagjen

Rrahmani në fshatin Dumnicë e Epërme, realisht lagja nuk quhet Rrahmani por quhet Lagja Rudari, është e vërtetë se projekti është dorëzuar në fund të vitit të kaluar kurse në këtë vit e kemi proceduar atë projekt dhe janë duke u zhvilluar punimet në fazën e parë në bazë të gjitha procedurave të kërkuara me ligj. Pastaj u shtrua kërkesa për asfaltimin e rrugës Lagja e Dëshmorëve, sa unë jam në dijeni ajo rrugë është e asfaltuar, por nëse është menduar të lidhet me rrugën që qon në drejtim të Livadicës, ajo është çështje tjetër. Gjithashtu u shtrua pyetja, pse nuk janë të specifikuara konkretisht Lagjet e fshatrave në të cilat mendohet të asfaltohen, përgjigja është se kemi fshatra ku një lagje e ka dorëzuar një projekt kurse kërkesat janë edhe të shumë lagjeve tjera, andaj për atë arsye unë nuk i kam potencuar në këtë fazë saktë se në cilat lagje do të investohen në mënyrë që deri në miratimin final të prioriteteve t'iu bashkëngjiten kërkesat dhe projektet konkrete atyre Lagjeve të cilat do të hynë në planifikim. Lidhur me pyetjen e cila kishte të bëjë me asfaltimin e rrugës së qytetit në Lagjen Babatinca-Stublla-Gubetini, përgjigja është, projekti për asfaltimi i rrugëve në qytet është në fazën e tenderimit, projekt në të cilin përfshihet edhe rruga e cekur, ndërsa sa i përket çështjes që u ngrit rreth heqjes së një shume të mjeteve dhe bartjes së projektit nga 2016 në 2018 për asfaltimin e rrugës në fshatin Revuç, është se vërtetë që komuniteti i fshatit e ka përgatitur dhe e ka dorëzuar projektin, mirëpo ky projekt është shumë voluminoz, në vitin e kaluar është përfunduar rruga kryesore e atij fshati por nuk kemi pasur mjete për të vazhduar tutje me asfaltim të lagjeve tjera më të thella, ndërsa arsyeja e zhvendosjes së projektit në vitin 2018 është se në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në ato mese ku rrugët janë të gjata kurse numri i shtëpive dhe i familjeve është i vogël ne do të intervenojmë me fazë të parë deri sa të krijohen mundësitë për asfaltim, po ashtu lidhur me këtë pyetje unë edhe në KPF e kam potencuar se ka fshatra dhe familje në zonën e brezit kufitar ku rrugët janë shumë më në gjendje të mjerueshme se në fshatin Revuç. Pra kjo është kornizë dhe në qoftë se ka kërkesa dhe propozime të arsyeshme për projekte konkrete ne ende jemi të gatshëm të shqyrtojmë mundësitë e plotësimit, ndryshimit të planifikimeve deri në miratimin final të prioriteteve.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, theksoi, u tha se në fondin e bujqësisë ka zbritje të shumës së mjeteve të planifikuara për vitin 2016, për dallim nga viti i kaluar, është e vërtetë se për vitin 2015 kanë qenë të ndara 450,000.00 € mirëpo me rishikimin e buxhetit janë bartur 50,000.00 € dhe kanë mbetur 400,000.00 €, ndërsa për vitin 2016 janë planifikuar 400,000.00 € kështu që nuk kemi as zbritje e as rritje të buxhetit të planifikuar për bujqësi, madje vlen të ceket se për vitin 2016 është projekti për klasifikimin e bonitetit të tokës, i cili sigurisht se do t'ia mundëson Komunës orientimin e investimeve në sektorin e bujqësisë në mënyrën më të mirë, por do të jetë edhe një program shumë i mirë për investorët e huaj. Sa i përket projektit për pemëtari i cili ka vlerën 100,000.00 € për të cilin u tha se janë vetëm për mjedra, unë ju sqaroj se nuk përfshihen vetëm mjedrat në këtë projekt por ka edhe subvencionim të aronisë dhe kulturave tjera të kësaj natyre. Lidhur me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, ju rikujtoj se në vitin 2014 ka qenë një shumë prej 10,000.00 € për investime kapitale, shumë e cila është kritikuar nga ana juaj me arsyetim se është shumë e vogël, mirëpo në vitin 2014 ne kemi pasur një planifikim dhe tani është në proces të realizimit, investimet kapitale në shumë 161,000.00 €, që do të thotë se ka pasur një ngritje, mirëpo si do që të jetë nuk dua të hy në projekte të këtij viti të cilat janë duke u realizuar. Sa i përket planifikimeve për vitin 2016, mendoj se është mirë të lexohet me

vëmendje i gjithë dokumenti i kornizës, sepse do të vërehet se nuk janë të planifikuara vetëm 140,000.00 € për investime kapitale, siç u tha, por janë edhe 80,000.00 € subvencione të cilat parashihen për ngritjen e fondit zhvillimor lokal në të cilën do të aplikohen programe të reja për ndërmarrësi, për të cilat nuk e shoh të arsyeshme tani të jap ligjërata se si zhvillohen, por e rëndësishme është se buxheti i kësaj Drejtorie është gjithsejtë 220,000.00 €. Gjithashtu u the se nuk dihet nga ana jonë se sa është numri i të punësuarve dhe i bizneseve, unë ju rikujtoj se nga viti 2000 deri tani janë 4045 biznese të regjistruara, ku prej tyre pronare femra janë 323, kurse pronarë meshkuj 3722, ndërsa numri i të punësuarve të deklaruar nga ana i bizneseve është 7237 persona të punësuar, por është më normale që inspektorët e Administratës Tatimore të Kosovës duhet të dalin në vendin e ngjarjes dhe të vlerësojnë gjendjen reale në terren, sepse punë e Drejtorisë është mbështetja dhe monitorimi i gjendjes së bizneseve aktuale, kurse bizneset që janë shuar janë 648, dhe numri aktual i bizneseve aktive është 3397.

z.Haki Rudari, theksoi, nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Mjedisit, u tha se nuk vërejtja ndonjë propozim projekt serioz, mendoj se propozimi për ndërtimin e një shkolle dhe i një çerdheje është problem i qytetarëve dhe është projekt shumë serioz. Po ashtu rreth çështjes që ka të bëjë me tregun e bulmetit, unë ju rikujtoj se të shtunën kur ne kemi bërë vizita bulmeti është shitur në trotuare, kurse prerja e pulave bëhet afër QKMF-së, drejtori Durim Salihu e tha se shumë Lagje nuk kanë projekte të hartuara andaj nuk po mund të përfshihen në prioritet, por të njëjtën kohë Lagja Rudari në fshatin Dumnice e ka hartuar dhe e ka dorëzuar projektin për asfaltim të rrugës së tyre, andaj përse nuk figuron në prioritet për vitin 2016. Sa i përket çështjes së ndërtimit të trotuareve, ne nuk jemi kundër investimeve në fshatra të ndryshme, mirëpo është mirë që Drejtoria përkatëse të përfshinë në prioritet fshatrat Shajkoc, Batllavë sepse këto kanë nevojë më shumë se sa disa fshatra tjera.

z.Flakron Gashi, theksoi, është mirë që drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik z.Avni Fetahu të mban shënime në mënyrë që përgjigjet t'i kthej konform shënimeve, unë nuk e ceka askund për investime kapitale, por e ceka shumë e paraparë për projekte prej 140,000.00 € për vitin 2016, gjithashtu më duket joprofesionale kur një drejtor e thotë, kam projekte mirëpo nuk e shoh të arsyeshme të foli për ato projekte, e këtë e tha drejtori i cekur, andaj nëse vërtetë ato projekte ekzistojnë do të ishte shumë e arsyeshme që ne të jemi në dijeni se cilat janë ato.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, theksoi, te performaca përkatësisht te kategoritë buxhetore përfshihet transfere dhe subvencione dhe parashihet një shumë prej 80,000.00 €, këtë e thash sikurse që e thash se, nuk e shoh të arsyeshme të foli për programe të reja të ndërmarrësisë se si mund të realizohen ato sepse këtë e keni në projekt dhe mund të vini kur do që të dëshironi në zyrë dhe të njoftoheni se si parashihet të realizohen për vitin 2016, pra nuk është diçka që ne vetëm e kemi planifikuar, por ka të bëjë me planifikim dhe me shuma konkretet mjeteve si dhe parashihet të realizohet.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit në hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016–2018 të Komunës së Podujevës, gjithashtu i falënderoj edhe qytetarët për pjesëmarrje në takimet e ndryshme që janë mbajtur, po ashtu edhe drejtorët e Drejtorive për punën e tyre secili në sektorin përkatës, Komitetin për Politikë dhe Financa për organizimin dhe mbajtjen e takimit publik me qytetarë, dhe gjithsesi i falënderoj të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës të cilët sot në këtë

mbledhje me diskutimet e tyre i kontribuojnë aprovimit të këtij dokumenti të rëndësishëm për Komunën e Podujevës. Me qenë se projektet janë ende në fazën e përgatitjes, ende mund të paraqiten propozime konkrete deri në afatin e paraparë për aprovim definitiv të projektbuxhetit të Komunës për vitin 2016 dhe projekteve prioritare për vitet 2016-2018, përkatësisht dërgimit të dokumentit final për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës, t'i fusim në mënyrë që projektet të cilat janë me prioritet të mos mbeten pa përfshirë. Jam i bindur se gjatë punës së këtyre faktorëve që unë i përmenda, sigurisht se kanë pasur parasysh prioritetet e Komunës të cilat janë të bazuara në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, e cila është aprovuar nga ky Kuvend, edhe pse ndonjëri nga këshilltarët sot gjatë diskutimeve i citoi disa gjëra nga ajo Strategji duke harruar që e njëjta është përgatitur, është diskutuar me diskutime publike dhe në fund është aprovuar në këtë Kuvend, andaj asgjë që është shkruar në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016–2018 nuk është diçka që nuk është paraparë në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal. Edhe pse nga disa këshilltarë pati parashikime, supozime, profetizime, unë i mirëkuptoj sepse ato nganjëherë bëhen edhe për efekt medial, por është mirë që çështjet të diskutohen ashtu sikurse që janë realisht, dhe mos të bëhet përpjekje për të hedhë mjegull në një hapësirë ku nuk ka vend për një gjë të tillë, ngase projektet në Komunën e Podujevës ju garantoj se nuk bëhen pa procedurat e kërkuara, nuk bëhen pa buxhet të paraparë, si dhe punojmë aq sa janë mundësitë, sepse fundja asnjë projekt nuk mund të hyjë në procedura të prokurimit pa pasur projekt në bazë të rregullave të reja. Unë e ceka edhe më parë se projektet ende janë në fazën e përgatitjes, dhe ndokujt mund t'i duket se ndonjëri projekt nuk e ka shumën e mjeteve buxhetore aq sa nevojitet, mirëpo duke pasur parasysh se projektet financohen prej burimeve të ndryshme, nuk bëjmë kurrfarë shkelje nëse parashohim apo dëshirojmë të realizojmë projekte sa më shumë që është e mundur sepse prapë e ritheksoj se ka burime të ndryshme të financimit të projekteve si; grandet e Qeverisë, donatorët e ndryshëm të cilët përgjatë viteve i kemi pasur, si dhe të hyrat vetanake, kështu që nuk ka vend për brengosje sepse nuk lejoj të përfshihen projekte pa mbulesë buxhetore që e garantojnë realizimin e atyre projekteve, dhe sigurisht se jeni në dijeni se Komuna e Podujevës është një ndër Komunat, ose mund të them lirshëm se ndoshta është e para që ka respekt të madh të disiplinës financiare ashtu sikurse që parashihet, dhe nuk dëshiroj që Komuna të futet në obligime të cilat nuk mund t'i përballoj. Gjatë diskutimeve u përmenden edhe disa çështje tjera, mirëpo rreth çështjeve që i ceka, sa për informim, para dy-tri ditëve më është dërguar edhe Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014, i cili është me vlerësime maksimale sa i përket shpenzimit të parasë publike, të cilin do të prezantoj edhe para juve këshilltarëve të Kuvendit ku do të kemi rast të diskutojmë bashkërisht sepse ashtu edhe parashihet. Jam i vetëdijshëm se Komunat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme buxhetore dhe as kapacitete tjera për ekonomik, e them këtë ngase kjo foltore nganjëherë po keqpërdoret sa i përket kësaj çështjeje. Kam premtuar, si në fushatë zgjedhore, si para qytetarëve, se do të ofroj kushte maksimale për zhvillim ekonomik, kushte të cilat janë edhe përgjegjësi e pushtetit lokal, përkatësisht Kryetarit të Komunës, dhe në këtë aspekt besoj se kemi arritur në masë të madhe të krijojmë kushte për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, sepse është bërë rregullimi i infrastrukturës, asfaltimi i një numri të madh të rrugëve, ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve dhe shumë e shumë infrastruktura tjera, kurse çështjet tjera janë përgjegjësi e tjetër kujt, shembull, uji, energjia, e të tjera, ndërsa përgjegjësitë të cilat i përkasin pushtet lokal, konsideroj se i kemi krijuar në gjithë territorin e Komunës së

Podujevës për ata njerëz të cilët dëshirojnë të investojnë kapitalin e tyre në zhvillim ekonomik, andaj me projektet e ndryshme nuk mund të themi se nuk i kemi kontribuar zhvillimit ekonomik dhe zvogëlimit të papunësisë në qoftë se janë ngritur shumë hektarë me pemishte, pastaj ta zëmë këtë vit janë ndarë 30 serra në sipërfaqe nga tre ari sigurisht se duhet të punojnë të paktën dy – tre punëtorë, gjithashtu nëse në këtë vit shpërndahen për 100 bletarë nga 10 shoqëri të bletëve sigurisht se është një kontribut sepse zbutet papunësia, pastaj në 100 hektarë me mjedra, e që në një hektar duhet të punojnë të paktën 5-6 punëtorë, sigurisht se edhe kjo është zbutje e papunësisë, andaj nuk mund të thuhet se Komuna e Podujevës nuk ka kontribuar, me apo pa qëllim kjo u tha këtu, dhe këto subvencione të të gjitha sferave ndahen në bazë të Rregullores së miratuar në këtë Kuvend për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, dhe ndryshim-plotësimit të saj, pra ndarja e tyre bëhet me rekomandim të Komisionit përkatës, i cili paraprakisht i shqyrton të gjitha kërkesat para se të dërgohen për aprovim te Kryetari i Komunës apo te organet tjera, kështu që do të ishte mirë të jemi më të përmbajtur dhe mos të përhapim dezinformacione të ndryshme të cilat nuk i kontribuojnë zhvillimit të përgjithshëm të Komunës. Po ashtu në formë të kërkesës u përmend edhe ndërtimi i një çerdheje, mirëpo çerdhja në qytetin e Podujevës është e ndërtuar dhe funksionale dhe është fat i mirë që ajo çerdhe ka kapacitet për 100 fëmijë, ndërsa sa jam në dijeni aktualisht janë 60 fëmijë që vijnë në çerdhe, kështu që në bazë të kërkesave ende nuk kemi nevojë për ndërtimin e çerdheve me kapacitete tjera.

Në fund, dëshiroj që edhe njëherë t'ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, dhe deri në momentin e aprovimit në këtë Kuvend, të projektbuxhetit të Komunës për vitin 2016 dhe projekteve prioritare për vitet 2016-2018, jemi të hapur dhe kushdo që ka projekte të arsyeshme sigurisht se ato do të përfshihen në këtë projektbuxhet.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, falënderoi Kryetarin e Komunës për sqarimet dhe arsyetimet e dhëna, dhe vuri në votim propozimin e *Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016–2018 të Komunës së Podujevës*.

Pas votimit u konstatua se me 21 vota për, 11 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, u miratua Korniza Afatmesme Buxhetore 2016–2018 e Komunës së Podujevës.

4. Të Ndryshme

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, sigurisht se jeni në dijeni se Udhëzimi Administrativ për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, në mënyrë decitive e parasheh se në përbërje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi duhet të jetë Komandanti i Stacionit të Policisë në secilën Komunë përkatëse.

Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë **z.Isak Ejupi** është emëruar në punë dhe detyra tjera të cilit njëherit i dëshirojmë suksese, kurse Komandant i ri në Stacionin e Policisë në Podujevë është emëruar **z.Bekim Bislimi**, kështu që kjo çështje rregullohet me automatizëm, mirëpo formaliteti sigurisht se duhet të përmbushet.

Konstatim:

z.Bekim Bislimi, në cilësinë e Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevë, caktohet anëtar i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

z.Flakron Gashi, theksoi, duke llogaritur që edhe pika katër është pikë e rendit të ditës, unë duke shfrytëzuar Rregulloren e Punës së Kuvendit, kam dy kërkesa për dy Drejtorë, të cilat me shkrim ua dorëzoj juve si Kryesues i Kuvendit dhe të njëjtat në vazhdim do t'i lexoi dhe njëkohësisht do t'jua dorëzoj dy drejtorëve të Drejtorive përkatëse, kërkoj nga:

1-drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave z.Isuf Latifi, që në raportin gjashtëmujor për periudhën janar–qershor, i cili do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës, për secilin projekt veç e veç krahas kostos dhe lokacionit ku është ndërtuar të jetë e cekur edhe kompania apo operatori ekonomik i cili ka ndërtuar apo që e ka implementuar projektin në fjalë. dhe kërkoj nga

2-drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, z.Abaz Llugaliu, që në seancën e ardhshme në muajin korrik, të sjell si informatë në formë të shkruar evidentimin e borxhit apo obligimeve të pa paguara për secilën pronë komunale të dhënë në shfrytëzim.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, kam dy pyetje, për:

1-drejtorin e Drejtorisë së Administratës, z.Fatmir Gashi, më intereson që pas përtrirjes së autoparkut dhe blerjes së veturave të reja nga Komuna, a është shitur ndonjë veturë e vjetër dhe nëse po, sa vetura janë shitur dhe sa mjete financiare janë inkasuar.

2-drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, z.Isuf Latifi, pagesat e komunitetit për hartimin e projekteve që i realizojnë, a evidentohen si të hyra vetanake apo ku evidentohen.

Pasi nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11;40

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-59694
Podujevë,
26 qershor 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**